



PASQYRA MAKROEKONOMIKE

Departamenti i Makroekonomisë përdorë të dhëna të publikuara nga institucionet relevante. Të gjitha burimet e të dhënave janë të paraqitura në fund të këtij publikimi.

Sektori Real

Nr.12, Janar - Mars 2013

Vlerësohet se ekonomia vendore përgjatë vitit 2012 u rrit me një shkallë prej rreth 2.4% për dallim nga rritja prej 4.5% sa ishte shënuar përgjatë vitit 2011.

3.7% janë parashikimet fillestare për zgjerim e aktivitetit ekonomik për vitin 2013, ku shtytës kryesor i kësaj rritje pritet të vije nga rritja e konsumit të përgjithshëm, kontributi i së cilës pritet të shënoj rreth 2.3%.

Për më shumë, investimet private pritet të kontribuojnë me rreth 1% në rritjen ekonomike përgjatë vitit 2013 dhe me rreth 0.8% kontribut nga investimet publike.

Kontribut në rritje ekonomike relativisht e ulët pritet të vije nga eksportet e mallrave dhe shërbimeve, shkalla e së cilës pritet të shënoj rreth 0.6%.

Përderisa, importet pritet të ndikojnë negativisht me rreth 1% në rritje ekonomike.


Gjatë këtij tremujori, çmimet e përgjithshme matur nga Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK) shënoj rritje, në mesatare prej rreth 2.9%.

Bazuar në raportimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), përgjatë këtij tremujori vërehet ngritje në çmimet e perimeve, duhanit, mishit dhe pjesërisht të bukës dhe drithërave.


Përderisa kjo ngritje u neutralizua nga rëniet në çmimet e sheqerit, qumështit dhe benzinës dhe naftës.

Bazuar në këto dhe informata shtesë, parashikohet se çmimet për vitin 2013 do kenë një ngritje prej rreth 1.7% në raport me vitin 2012.

Rritja vjetore e BPV -së , në përqindje (%)



Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit, IÇK (në %)



Sektori i Jashtëm

Përgjatë tremujorit të parë të vitit 2013, vlera e mallrave të eksportuar dhe mallrave të importuara shënuan ngritje.

Vlera e eksporteve të mallrave gjatë tremujorit të parë shënoj rreth €67.3 milionë, vlerë e cila është më e lartë për rreth 15.2% në raport me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

Sikurse gjatë viteve paraprake, **metalet bazë** ishin produktet kryesore të **eksportuara**, pasuar nga produktet e mineraleve, produktet ushqimore, plastika dhe druri, makineritë dhe pajisjet elektrike.

Për më shumë, partnerët kryesor tregtar mbetën të njëjtit sikurse në periudhat paraprake, ku vendet e **BE-së** mbesin destinacioni kryesor i produkteve nga Kosova.


Importet e mallrave vazhduan të ngriten. Tremujori i parë shënoj 5.9% ngritje në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Deri në fund të periudhës raportuese (Mars, 2013) vlera e mallrave të importuara arriti në €484.6 milionë.

Produktet minerale (kategori e cila përfshinë importin e naftës) është kategoria kryesore e importuar, pasuar nga ushqimi i përgatitur, pijet dhe duhani dhe pajisjet makinerike.

Si rezultat i rritjes më të shpejt të mallrave të importuara në raport me mallrat e eksportuara, bilanci negativ tregtarë u ngrit për rreth 4.5% me shumë gjatë këtij tremujori në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Importi, eksporti dhe bilanci tregtar, në miliona euro



Sektori Fiskal

Zhvillimet fiskale përgjatë tre-mujorit të parë të vitit ishin më pozitive në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, me theks të veçantë në pjesën e të hyrave të rregullta buxhetore.

Të hyrat e përgjithshme në fund të tremujorit të parë të vitit shënuan rreth €274 milionë, shifër e cila është më e ulët për rreth 4.6% në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2012.


Të **hyrat nga dogana**, si burim kryesor i të hyrave të përgjithshme, përgjatë tremujorit të parë të vitit shënuan €147.2 milionë, shifër e cila është më e lartë për rreth 3.3% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Tatimet vendore, të arkëtuara nga Administrata Tatimore e Kosovës, shënuan rritje prej rreth 12.6% në raport me vitin e kaluar duke shënuar vlerë prej rreth €72.9 milionë përgjatë tremujorit të parë të vitit.

Shpenzimet e përgjithshme në fund të tremujorit të parë të vitit shënuan €292.6 milionë, për të shënuar rritje prej rreth 1.7% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Shpenzimeve kapitale gjatë tremujorit të tretë të vitit ishin më të ulëta për rreth 20% krahasuar me tremujorin e parë të vitit paraprak.

Të hyrat buxhetore, në milion euro



Shpenzimet rrjedhëse shënuan ngritje në krahasim me periudhat paraprake. 15.1% ishte ngritja në raport me tremujorin parë të vitit paraprak.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në miliona euro



Sektori Financiar

Sektori bankar vazhdoj zgjerimin e saj edhe gjatë këtij tremujori. Asetet totale të sektorit bankar shënuan ngritje prej rreth 7.6% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, dhe ngritje prej rreth 0.2% në krahasim me tremujorin paraprak.

Depozitat në sektorin bankar në fund të tremujorit të parë të vitit shënuan rreth 2.3 miliardë, shifër e cila është më e lartë për 8.0% në raport me tremujorin e parë të vitit 2012.

Kreditë arritën vlerën prej **€1.7 miliardë** në fund të muajit mars 2013 duke shënuar një ngritje vjetore prej **3.8%** dhe 1% ngritje në raport me tremujorin paraprak.

Sektorët me pjesëmarrje më të madhe në kredi-marrje ishin sektori i shërbimeve, energjetikës, industrisë dhe ndërtimtarisë dhe sektori i bujqësisë.

Norma mesatare e **interesit në kredi** përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 shënoj **12.63%**, ndërsa norma mesatare e **interesit në depozita** shënoj **3.54%**.

Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Tabela 1. Agregatet kryesor ekonomik dhe fiskal

Përshkrimi	2012			2013		
	Janar	Shkurt	Mars	Janar	Shkurt	Mars
<i>(në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)</i>	<i>miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe</i>					
Rritja vjetore e BPV -së						
Sektori Real						
IÇK (në %)	2.9	1.7	0.6	3.6	2.6	2.6
Projeksioni I IÇK-së (në %)						
Sektori i jashtëm						
Importi i Mallrave	132.2	125.2	200.2	133.0	156.4	195.3
Eksporti i Mallrave	19.2	15.3	23.9	21.5	22.7	23.1
Bilanci tregtar	-113.0	-109.9	-176.3	-111.5	-133.7	-172.2
Sektori Fiskal						
Të hyrat e përgjithshme	93.4	82.0	111.9	89.5	74.7	109.83
Të hyrat nga kufiri	40.1	45.7	56.8	44.2	45.9	57.1
Të hyrat vendore	29.3	20.1	15.3	33.85	19.84	19.22
Të hyrat jo tatimore	3.4	2.3	3.5	2.58	2.6	5.6
Te hyrat nga dividendat	-	-	15.0	0	-	20
Mbështetja buxhetore	0.7	-	-			
Kreditë (disbursimet)	10.0	9.9	9.9	0.2	1.6	0.2
Shpenzimet e përgjithshme	30.1	148.8	108.9	38.9	137.9	115.83
Shpenzimet Rrjedhëse	22.7	73.6	81.6	30.7	85.0	89.0
Shpenzimet Kapitale	7.4	75.1	27.3	8.2	52.9	26.8
Remitancat			119.1			
Sektori Financiar						
Depozitat	2,113.5	2,123.4	2,087.5	1,754.9	1,765.6	2,269.4
Kreditë	1,683.1	1,692.2	1,717.1	2,265.1	2,278.3	1,782.7
MHN te korporatave financiare			2,087.9			

Burimi i të dhënave:

Sektorit Real dhe Sektorit i Jashtëm: Enti i Statistikave të Kosovës <http://www.ks-gov.net/esk/>

Sektori Fiskal: Departamenti i Thesarit, MF: <http://www.mef-rks.org/>

Sektori Financiar: Banka Qendrore e Kosovës : <http://www.bqk-kos.org/>